

Statuti

i

Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“BAR CLASSIC” sh.p.k

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “Bar Classic” sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin 9901 dt. 14.04.2008 “Per shoqerite tregetare” dhe Ligjin 9723 dt 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Biznesit me ndryshimet e nevojshme.

Kjo shoqeri krijohet nga ortaket:

- Martin Çani, I biri I Spartak dhe Violeta Çani, lindur dhe banues ne Gjirokaster me 28.05.1986, identifikuar me nr ID I6052091K, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- Taulant Toro, I biri I Perlat dhe e Lumtëri Toro , lindur dhe banues ne Gjirokaster me 14.05.1990, identifikuar me nr ID J00514097G, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Shoqeria “Bar Classic” sh.p.k e zhvillon aktivitetin dhe veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne Statutin e Saj.

Neni 3

Shoqeria “Bar Classic” sh.p.k krijohet sot me 01.06.2018 per te zhvilluar aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar.



Por shoqeria mund te shperbehet edhe para ketij afati me miratimin e asamblese te jashtezakonshme, sipas rasteve te parashikuara ne Statutin e kesaj shoqerie me miratimin e ortakeve Themelues te shoqerise (shperberja dhe likujdimi).

Neni 4

Qendra e kesaj shoqerie do te jete ne adresen ne lagjen 18 Shtatori, Gjirokaster me nr. Pasurie 28/78-N-5, nr. 28/244

Me te drejte per ta ndryshuar, per te hapur filiale te tjera ne te gjithe Republiken e Shqiperise, por edhe jashte saj ne perputhje me Legjislacionin ne fuqi.

Asambleja e shoqerise mund te krijojë, modifikojë apo anullojë seli sekondare, agjenci dhe perfaqesi kudo qe e shikon te nevojshme edhe jashte shtetit.

Qendra fiskale e ortakeve per sa u perket raporteve me shoqerine, eshte selia e shoqerise.

Neni 5

OBJEKTI I AKTIVITETIT TE KESAJ SHOQERIE DO TE JETE:

Bar kafe. Shoqeria mund te realizoj çdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "Bar Classic" sh.p.k me kapital themeltar 100.000 leke (njeqind mije) , I ndare ne 2 (dy) kuota me nje vlere 50 000 leke secila. Me ortake themelues z. Martin Çani me 1 kuote dhe Taulant Toro me 1 kuote.

Fondet qe vijne nga derdhjet e parave ne vazhdim te aktivitetit do te kreditohen ne llogari bankare ne emer te shoqerise "Bar Classic" sh.p.k ne bankat e ndryshme qe zhvillojne aktivitetin e tyre ne Republiken e Shqiperise, por edhe jashte shtetit.

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme, ne rruge trashegimie, ne rast fatkeqesie ndermjet bashkeshorteve, duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe me vendim gjykate.



Te gjitha veprimet e shoqerise (kalimi I kuotave ne persona te trete) mbi kapitalin themeltar ne natyre behen me vendim te ortakeve themelues te shoqerise dhe me akt noterial.

Derdhja e kuotave behet si me poshte:

- Martin Çani do te derdhe pas rregjistrimit shumen 50.000 leke
- Taulant Toro do te derdhe pas rregjistrimit shumen 50.000 leke.

Neni 7

Me rritjen e aktivitetit te shoqerise, kapitali themeltar mund te shtohet si ne vlere ashtu edhe ne natyre.

Neni 8

Ne rast shtimi te numrit te ortakeve , pakesim per cdo ortak do te behet me vendim te perbashket te Asamblese se Ortakeve dhe ne raport me perqindjet qe ai posedon .

Neni 9

Rritja ose zvogelimi I kapitalit themeltar behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ne rast kur shoqeria perbehet nga me shume se nje ortak , vendimet jane te vlefshme kur ato merren nga ortaket qe perfaqesojne me shume se $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar.

Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane lehtesisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve ne shoqeri per transferimin ne rruge trashegimore ortaket mund te veprojne sipas ligjit por duke vendosur paraprakisht me vendim te asamblese se ortakeve "Per shoqerite tregetare".

Neni 11

Pjeset e kapitalit themeltar mund te jene te transferueshem te personat e trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri.

Transferimi eshte I vlefshem kur behet me vendimin e ortakeve qe posedojne jo me pak se $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ne kete rast veprohet sipas ligjit "Per shoqerite tregetare"



Neni 12

Organet drejtuese te shoqerise "Bar Classic" sh.p.k do te jene:

- Asambleja e pergjithshme e ortakeve.
- Administratoret
- Administrator I shoqerise "Bar Classic" sh.p.k emerohet Mikele Mosho I identifikuar me ID J00608097C ,per nje afat pese vjet dhe me te drejte rizgjedhjeje.

Neni 13

Administrator I shoqerise per nje periudhe deri ne pese vjet te aktivitetit te tij do te veproje bashkarisht me ortaket themelues per drejtimin e aktivitetit te shoqerise, duke zbatuar kompetencat e tij ne baze te vendimeve qe do te merren nga asambleja e ortakeve per zbatimin e aktiviteteve, dhe sipas dispozitave perkatese qe jane percaktuar ne Statut.

Administratori ka te gjitha kompetencat qe I jep Vendimi I Asamblese te Ortakeve "Per Shoqerite Tregetare".

Administratori mund te kryej veprime per hapjen e llogarive bankare prane cdo banke, per derdhjen dhe terheqjen e llogarive bankare te shoqerise "Bar Classic" sh.p.k, gjithmone duke marre Venimin e Asamblese se Ortakeve me jo me pak se $\frac{3}{4}$ e pjese marrjes.

Administratori perfaqeson shoqerine ne te gjitha merreveshjet juridike me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

Neni 14

Organi administrative (administratori) ka fuqi ne manaxhimin e rregullt te shoqerise.

Ka detyrim ligjor te kryeje me perpikmeri te gjitha detyrimet per funksionimin normal te shoqerise, sipas dispozitave te ketij Statuti dhe Vendimit te ortakeve.

Neni 15



Asambleja e ortakeve vendos me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit me jo me pak se $\frac{3}{4}$, ose kur ligji ose statute e e percaktojne ndryshe.

Asambleja e ortakeve ka kompetence te vecante per vendimet e ndryshme dhe aktet e manaxhimit.

Asambleja e ortakeve ka kompetence te vecante per aktet ne vazhdim: si blerje , kembim apo ndarje te pasurive te patundshme, qiramarrje dhe ndarje te ambjenteve te shoqerise, kerkese afatshkurter per financim, afatgjate per ndersjelljet hipotekore, pjesemarrje ne shoqerite tjera te korporates dhe ne formen e nje dhenieje, hapjen e llogarive rrjedhese ne bankat, emerimet e drejtoareve dhe administratoreve, vendosjen e attributeve dhe autorizimin e cdo akti noterial.

Neni 16

Ortaket mund te bejne me kerkesen e organit administrative dhe ne perputhje me efektshmerine e dispozitave fiskale derdhje ose financime si produktive dhe jo produktive gjithmone me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Ne rast derdhje ne llogarine kryesore, shumat relative mund te perdoren me Vendim te Ortakeve per mbulimin e humbjeve te ndryshme ose levizjeve te kapitalit ne cdo import.

Neni 17

Cdo ortak ka te drejte te nderhyje ne asamble, mund te perfaqesohet nga nje individ qe nuk eshte ortak me anen e nje Prokure, e cila duhet te ruhet nga shoqeria.

Ne Prokure duhet te specifikohet emri I perfaqesuesit me te dhenat identifikuese te tij.

Nese prokura behet vetem per nje mbledhje, ajo ka vlere vetem per te.

Neni 18

Shkarkimi I administratoreve te shoqerise behet sipas dispozitave qe percaktohen ne ligj.

Ne rast te shtimit te numrit te ortakeve , shkarkimi I administratoreve behet nga ortaket qe posedojne me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit themeltar.

Neni 19

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimit, Ortaket percaktojne pjesen e fitimit qe u takon, pasi te jene zbritur pjesa qe do te kaloje ne fondin reserve te domosdoshem.



Pjesa qe mbetet nga fitimi pasi te jene zbritur pjesa qe do te kaloje ne fondin reserve, pjesa per fondet e tjera eventuale dhe pasi te jete bere likujdimi I te gjitha detyrimeve tatimore u perket ortakeve te cilet kane te drejte ta disponojne teresisht.

Neni 20

Veprimet e shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik.

Ne fund te cdo periudhe ekspertet bejne llogarite vjetore, bejne bilancin kontabel ose rezultatin ekonomik te fitimit ose humbjes sipas ligjeve financiare ne fuqi.

Llogarite vjetore, inventari, raporti mbi veprimet financiare dhe raportet e vecanta te perpiluara nga administrator dhe eksperti kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve.

Aprovimi I dokumentave mbi aktivitetin vjetor behen Brenda afatit, tre muaj nga data e mbylljes se vitit financiar, duke respektuar procedurat e percaktuara me ligj.

Neni 21

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne Statut, zgjatja e tij behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ajo priset kur mbaron afati I percaktuar nga ortaket dhe ne se nuk ka rene dakort qe te kryje riprteritjen e ketij afati.

Shoqeria mund te shenderrohet ne nje nga format e percaktuara dhe te kerkuara me ligji.

Neni 22

Shoqeria Tregetare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj.

Per fillimin e ketij procesi Asmbleja e ortakeve emeron nje Likujdues, I cili paraqet Raportin e Likujdimit, gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre.

Ne perfundim te ketij procesi te likujdimit Asambleja e Ortakeve vendos mbi Bilancin perfundimtar, aktin dhe rregullsine e Likujdimit, mbylljen e procesit te Likujdimit te shoqerise.

Neni 23

Marredheniet e Shoqerise me te punesuarit rregullohen nepermjet kontrates se punes.

Ne rast te kundert, aplikohen dispozitat e Legjislacionit Shqiptar.



Neni 24

Shoqeria "Bar Classic" sh.p.k eshte I pavarur dhe ka te drejta dhe detyrime, per te cilat pergjigjet brenda limiteve te percaktuara nga Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" me ndrysimet e mevonshme.

Neni 25

Mosmarreveshjet e Shoqerise me te trete, me persona Juridik ose Fizik shqiptare ose te huaj zgjidhen me mirekuptimin e Asamblese se Ortakeve, ne te kundert ato zgjidhen sipas legjislacionit Shqiptar ose sipas percaktimeve percaktimeve te bera ndermjet paleve.

Neni 26

Ky STATUT u perpilua ne 2 (dy) kopje me te njejten vlere ligjore ,nga te cilat nje kopje ne QKB dhe nje mbahet ne zyrat e shoqerise.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Bar Classic" SH.P.K

MARTIN SPARTAK ÇANI



TAULANT PERLAT TORO

